



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d) dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, nenit 13, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës nr. 06/L-092, nenit 6 paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr. 09/2020, nenit 33.2, shkronja a), dhe nenit 34.1 shkronja d) të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 30.3.2026, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE TË**  
**PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM**  
**NË VITIN 2026**

1. **MIRATOHET** Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2026.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, lista për secilën pronë të paluajtshme përmban: nr. e parcelës, sipërfaqen në m<sup>2</sup>, zonën kadastrale dhe destinimin e dhënies në shfrytëzim.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e veçantë e pronave të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, përfshirë certifikatën e pronësisë, kopjen e planit si dhe dokumentacionin tjetër relevant për secilën pronë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Pronës dhe drejtoritë e tjera relevante me të.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-463/03-46002/26, më 30.3.2026

**KRYESJESI I KUVENDIT**  
Behni Kupina

